

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Macklemore largohet nga turneu i Ed Sheeran, por nuk pendohet? Pse? Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/macklemore-largohet-nga-turneu-i-ed-sheeran-por-nuk-pendohet-pse/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:02:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:53:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fbeeb641364de0ed2b484e6c0f4ace37d6a1499713e3d970048cf04449310199
TEKSTI	0365c6f93f04b6d01ddd88fcfdeef1dd976959de858ef4b6cd934b48863f61b0
PAMJA	310ffb84bd3c410c2040fea6030dd2881ecbcd28b9831b7032a701cd1f748052

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec8dc17118acdf1f0d673560e0187e49a95eaf59d7a53e9e3c5bd70e69cbcf8c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ec8dc17118acdf1f0d673560e0187e49a95eaf59d7a53e9e3c5bd70e69cbcf8c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Macklemore largohet nga turneu i Ed Sheeran, por nuk pendohet? Pse?



Redaksia K

15 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Macklemore është larguar nga pjesa e mbetur e turneut amerikan të Ed Sheeran, pasi deklaratat e tij në mbështetje të Palestinës gjatë koncerteve në New Jersey shkaktuan polemika dhe reagime të forta.

Reperi amerikan, i cili ishte parashikuar të performonte si artist mbështetës në disa prej koncerteve të "Loop Tour", konfirmoi se nuk do të jetë më pjesë e datave të ardhshme. Promotori i turneut tha se disa prej ambienteve ku do të zhvilloheshin koncertet kishin bërë të ditur se nuk do ta lejonin Macklemore të performonte, duke rrezikuar anulimin e shfaqjeve.

Debati shpërtheu pas dy koncerteve të Macklemore në MetLife Stadium, ku ai foli hapur për situatën në Gaza dhe bëri thirrje për çlirimin e Palestinës.

"Free Palestine", u shpreh ai nga skena, duke thënë se një prej arsyeve pse kishte pranuar të ishte pjesë e turneut ishte pikërisht mundësia për të përcjellë këtë mesazh para një audience të madhe.

Gjatë performancës së këngës së tij protestuese "Hind's Hall", Macklemore shfaqti gjithashtu pamje që lidhen me luftën në Gaza dhe protestat pro-palestineze. Deklaratat shkaktuan reagime nga disa organizata dhe figura publike, ndërsa u kërkua edhe largimi i reperit nga turneu. Sipas Macklemore, presioni erdhi edhe nga drejtues të disa stadioneve amerikane.

Në një deklaratë të gjatë, ai pretendoi se Robert Kraft, pronari i Gillette Stadium, i kishte thënë Ed Sheeran se Macklemore nuk do të lejohej të performonte në stadium dhe se më pas disa pronarë të tjerë kishin bërë të njëjtën kërkesë.

Promotori i turneut konfirmoi se disa ambiente nuk do të lejonin zhvillimin e koncerteve nëse Macklemore mbetet pjesë e programit, duke argumentuar se kjo mund të ndikonte te qindra mijëra fansa që kishin planifikuar të merrnin pjesë.

Megjithatë, pavarësisht humbjes së mundësisë për të performuar në pjesën tjetër të turneut, Macklemore nuk duket se është penduar për atë që tha.

Në deklaratën e tij, ai theksoi se nuk kishte nevojë për të gjitha koncertet e planifikuara.

“Nuk më duheshin 10 shfaqje nga Ed. Më duheshin 2. Dy mundësi për të qëndruar përballë 90 mijë njerëzve dhe për të thënë fjalët që disi u bënë tepër të rrezikshme për t'u thënë. Free Palestine.

Më pas, ai bëri deklaratën që ka tërhequr më shumë vëmendje:

“Por nëse ato fjalë më kushtuan skenën, ndërsa e rikthyen bisedën te Palestina, atëherë ky ishte turneu më i suksesshëm që kam bërë ndonjëherë.

Macklemore u përpoq gjithashtu të ndajë kritikën ndaj qeverisë së Izraelit nga qëndrimi ndaj hebrenjve, duke iu drejtuar drejtpërdrejt anëtarëve hebrenj të publikut gjatë një prej koncerteve.

“Kritika ndaj Izraelit, kritika ndaj apartheidit, të qenit kundër gjenocidit në asnjë mënyrë nuk është kritikë ndaj jush. Mesazhi im është për paqe, dashuri; që të gjithë njerëzit të trajtohen me dinjitet, respekt dhe barazi.

Nga ana tjetër, kritikën ndaj reperit kanë ardhur nga disa organizata dhe persona publikë, të cilët e kanë akuzuar se po përdorte skenën e një koncerti për të përcjellë një mesazh politik. Këngëtarja Pink reagoi gjithashtu ndaj polemikës, duke thënë se deklaratat e Macklemore e kishin shqetësuar atë dhe njerëzit e saj të afërt.

Ndërkohë, Macklemore ka bërë të qartë se largimi nga turneu nuk do ta ndryshojë qëndrimin e tij.

Për të, humbja e skenës së Ed Sheeran nuk është pika kryesore e historisë. Ajo që ka rëndësi, sipas tij, është se mesazhi për Palestinën arriti te një audiencë prej dhjetëra mijëra njerëzish.

“Free Palestine”, ishte mesazhi me të cilin Macklemore zgjodhi të mbyllte deklaratën e tij, duke e kthyer largimin nga turneu në një tjetër kapitull të aktivizmit të tij publik për çështjen palestineze.

LAJME TË NGJASHME



Taylor Swift dhe Travis Kelce organizojnë “dasmën e shekullit”! Kush ishin disa nga të ftuarit?

2.5 MIN



Ed Sheeran mund të jetë performuesi surprizë në dasmën e Taylor Swift dhe Travis Kelce?!

1 MIN



“Ju dua, por kam nevojë për...”/ Ed Sheeran paralajmëron largimin nga skena?

2.5 MIN



“Ajo është mirë tani. Iu nënshtua një operacioni...” Ed Sheeran zbulon periudhën kur gruaja e tij ishte me kancer!



“Ishte dita më e keqe e jetës” Ed Sheeran rrëfen momentin kur mësoi se gruaja e tij kishte kancer!

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air Albania"-s!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish në skenë me 38 koncerte?



Arrestë i Erion Veliaj, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..." / Shkënda Lili habit me rastin: Kishte kapur disa foto intime në...



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Kujtimet në Top Channel dhe dashuria për ekranin, "rikthehet" Albana Osmani: Do të doja të bashkëpunoja me Ledionin...



Sydney Sweeney pozon nudo për reklamën e re dhe shpërthen polemika? "Po seksualizohet sporti..."



Për kë vazhdon të blejë lule te dyqani i motrës së Stelinës? Miri zihet ngushtë: Për atë...



Makina përplas 69-vjeçarën me biçikletë, ndërron jetë rrugës për Tiranë!



"E ëma e qëllloi me gur për ta vrrarë", Pastor Vilajeti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi!

EDITORI SUGJERON



Sasia ideale e proteinave që duhet të hani në mëngjes, sipas një dietologu...



4 kardiologë tregojnë ushqimet që konsumojnë rregullisht për të ndihmuar në uljen e tensionit dhe...



7 ilaçe që mund të ndërveprojnë me çajin jeshil?!



Tom Holland bën histori në Hollywood, bëhet aktori me filmat më fitimprurës të të gjitha kohërave!



Pyetëm një dietolog nëse yndymat e kikirikëve janë të mira për zemrën?! Ja se çfarë tha...



"Seven Up!" i jep lamtumirën kamerës pas 62 vitesh, fëmijët që u filmuan në moshën 7-vjeçare festojnë 70-vjetorin!



Çfarë mund të ndodhë nëse hani avokado rregullisht?!



Cili është lloji më i mirë i drithërave për të ulur kolesterolin?!



Koha më e mirë për të ngrënë kumbulla të thata për tretje më të mirë!



7 mënyra të shëndetshme për t'i dhënë shije të ëmbël tërshërës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktimi](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.